



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:243742

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06345422

C.nr.668/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.A, F.H, F.H dhe i mituri A.H të cilin e përfaqëson përfaqësuesja ligjore- nëna A.A, ndërsa të gjithë i përfaqëson sipas autorizimit Studio e Avokaturës “Avokatura A-R”, në Prishtinë, avokati R.P, kundër të paditurave Kompania e sigurimeve “D” dhe Kompania e sigurimeve “E”, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës, me datë 24.10.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET e tërhequr padia C.nr.668/2019, e datës 26.09.2019, e paditësve A.A, F.H, F.H dhe i mituri A.H kundër të paditurave Kompania e sigurimeve “D” dhe Kompania e sigurimeve “E”, për kompensim dëmi.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit me datë 26.09.2019, përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar kanë ushtruar padi në këtë gjykatë kundër paditurave Kompania e Sigurimeve “D” dhe Kompania e Sigurimeve “E”, për kompensim dëmi.

Gjykata me datë 22.10.2024, ka caktuar seancën përgatitore në të cilën kanë munguar e autorizuara e paditëseve, e po ashtu edhe të paditurat.

Mirëpo, përfaqësuesi i paditësve Av .R.P , përmes parashtrësës së pranuar në gjykatë më datën 14.10.2024, e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë për shkak se paditësit kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore me të paditurat ashtu që të paditurit kanë përmbushur të gjitha detyrimet ndaj paditëseve.

Sipas nenit 261 par 1, të Ligjit të Procedurës Kontestimore përcaktohet që *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.”*, ndërsa me paragrafin 3, të këtij neni thuhet se *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*.

Andaj në kuptim të dispozitës së lartcekur, pasi paditësit e kanë tërhequr padinë me arsyetimin se kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore me të paditurit, gjykata vendosi si në dispozitivin I të këtij aktvendimi.

Lidhur me vendimin si në dispozitivin II, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Andaj, nga të lartcekurat, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:243742, C.nr.668/2019, me datë 24.10.2024

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Në bazë të nenit 261 par 4, të LPK-së, ndaj këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.